

Drejtimit Strategjike	Prioritetet	Masat	% e realizmit prezantuar nga përfaqësuesit e qeverisë gjatë takimit të KKSHC	Komente nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim bazuar në raportet e monitorimit të mjedisit mundësues për shoqërinë civile dhe në informacionin marrë nga institucionet
Drejtimi strategjik 1: Institucionalizimi i bashkëpunimit qeveri - shoqëri civile për bashkëpunim në hartimin e politikave dhe integrimin në BE	Prioriteti 1: Krijimi dhe mirëmbajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile: Masat 1.1.-1.5	Masa 1.1. Planifikimi dhe zbatimi i duhur i Udhërrëfyesit sipas planeve të tyre tremujore dhe vjetore	100 %	Nuk ka patur informacion publik dhe ende nuk ka, as për planifikimin as për zbatimin nga ana e institucioneve përgjegjëse. Nëse kjo do të ishte realizuar 100%, në të njëjtën masë do të ishte realizuar edhe Udhërrëfyesi.
		Masa 1.2 Garantimi i përfshirjes aktive të OSHC-ve në ecurinë e Udhërrëfyesit përmes një dialogu gjithëpërfshirës me këtë sektor	100%	Bazuar në përgjigjen e marrë nga AMSHC-ja si sekretariat i KKSHC-së, është zhvilluar vetëm një takim midis anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit mbi diskutimin e ligjtn 80/2021 "Per regjistrimin e OJF-ve". Website i AMSHC-së në lidhje me veprimtarinë e KKSHC përmban vetëm njoftime, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve dhe procesverbalet. Website nuk përmban hapësirë komunikimi, platformë për marrje feedback-u dhe përfshirje të OSHC-ve.
		Masa 1.3. Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecurisë së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve	75 %	Nuk ka informacion publik lidhur me këtë masë.
		Masa 1.4 Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun	50%	
		Masa 1.5 Hartimi i Strategjisë Kombëtare/Udhërrëfyesit 2024-2028 për mbështetjen e OSHC-ve	0%	

	<p>Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të: Masat 2.1-2.9</p>	<p>Masa 2.1 Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë</p>	<p>85%</p>	<p>KKSHC vazhdon të mbetet strukturë joefektive dhe funksionale e të mos e luajë rolin e tij për rritjen e bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile, në dobi të zgjerimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike, nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces. Ndër vite, KKSHC nuk ka realizuar numrin minimal të mbledhjeve të përcaktuara në ligj. Në vitin 2022, mbledhja e 22 qershorit është e para. Gjatë vitit 2021 nuk është realizuar asnjë mbledhje e KKSHC por vetëm një takim i përfaqësuesve të shoqërisë civile në KKSHC. Situata ka qenë e ngjashme edhe në vitet paraardhëse. Përveç numrit të mbledhjeve, edhe në rastet kur mbledhjet janë realizuar, diskutimet janë fokusuar në prezantimin e antarëve të rinj të Këshillit, si dhe prezantime nga ana e Qeverisë për iniciativa të ndryshme, pa patur diskutime të qenësishme mes përfaqësuesve të organizatave dhe të qeverisë për çështje problematike për sektorin.</p>
		<p>Masa 2.2 Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për Këshillin, përfshirë cilësinë përgatitjes për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktiviteteve të Këshillit.</p>	<p>75%</p>	<p>Si pjesë e kësaj mase do duhej të ishte rritur stafi i AMSHC-së si dhe të pajisej AMSHC me burimet e nevojshme për mbështetjen e KKSHC-së (3 persona). Në raportet vjetore është cituar që ka patur rritje të numrit të stafit, por në website të AMSHC-së, për KKSHC-në është vetëm një person kontakti.</p>

		Masa 2.3 Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve	100%	Masë e realizuar.
		Masa 2.4 Përfshirja e KSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile	100%	Vetëm në ndonjë rast ka informacion publik mbi këtë përfshirje (si p.sh. diskutimi për projektligjin “Për regjistrimin e OJF-ve”). Për raste të tjera, nuk ka informacion publik.
		Masa 2.5 Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së Agjencisë për periudhën 2015-2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbushjen e rolit të saj si sekretariat i KSHC-së.	100%	Në Raportin vjetor të AMSHC, nuk reflektohet puna me KSHC.
		Masa 2.6 Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMSHC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të lokale	100%	Në website të AMSHC nuk ka të publikuar një plan komunikimi.
		Masa 2.7 Vazhdimi i asistencës teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës	100%	
		Masa 2.8 Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit	100%	
		Masa 2.9 Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministritë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-të	100%	Bazuar në kërkesën për informacion të Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dërguar ministrive në kuadër të përgatitjes së Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2021, si dhe informacionit zyrtar publikuar në faqet përkatëse, asnjë ministri nuk ka caktuar pikë kontakti me OSHC-të. Për më tej, nëse do të ishin caktuar, sikurse përcaktohet edhe në udhërrëfyes duhet të ishin bërë publike.

	Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efiçente e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes	Masa 3.1 Garantimi i zbatimit efikas të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin përmes ndërgjegjesimit në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të OSHC-ve	100%	Në lidhje me këtë masë është e paqartë se si është matur garantimi i zbatimit efikas të ligjit dhe arritja 100 % e rezultatit. Konsultimet dhe pjesëmarrja e OJF-ve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në një shkallë të gjerë mbeten joefektive, pavarësisht nga mekanizmat e bashkëpunimit të vendosur nga qeveria. Referuar raporteve të studimit nga sektori si dhe të institucioneve ndërkombëtare (Raporti i Progresit të BE për Shqipërinë, Raporti i Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2021 etj.) zbatimi me efikasitet i konsultimit publik dhe përfshirja e qenësishme e OSHC-ve në proces mbetet problematike. Në raportet e akteve, vijon të mos evidentohet pjesëmarrja e OSHC-ve dhe përfshirja e tyre.
		Masa 3.2 Përshtatja e regjistrimit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OSHC-të si një kategori më vete kontribuesish	100%	Përdorimi i regjistrimit nuk mundëson identifikimin e OJF-ve dhe as numrin e tyre. Nuk ka raport publik mbi sa OJF e vizitojnë dhe e përdorin regjistrin.
		Masa 3.3 Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimmarrjes	100%	
		Masa 3.4 Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi	100%	Masë e realizuar.
		Masa 3.5 Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike	100%	
	Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në BE	Masa 4.1 Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian	100%	Masë e realizuar.

	në përputhjen me praktikat e mira të BE-së			
		Masa 4.2 Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian	100%	<p>Në lidhje me këtë masë është e paqartë se si është matur përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit dhe arritja 100 % e rezultatit. Përtej informacionit mbi strukturat dhe procesin e negociatave, si dhe cilat janë 33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit për kapitujt acqui, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian nuk përmban informacion mbi aktivitetet që po zbatohen. Edhe pse janë krijuar disa tryeza diskutimi dhe këshillimi, ajo nuk ofron asnjë informacion mbi numrin e tyre, anëtarët e tyre, apo informacion rreth minutave të takimeve. Pavarësisht skepticizmit të shprehur nga aktorët e shoqërisë civile mbi qartësinë e kriterëve të aplikimit dhe vendimmarrjes për pjesëmarrjen në këto tryeza, nuk është konstatuar përmirësim. OJF-të duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e integritimit në BE, duke përdorur efektivisht hapësirën që kanë në Platformën e Partneritetit për Integrim Evropian dhe mekanizmat e tjerë të konsultimit, ndërkohë që institucionet publike duhet t'i bëjnë këta mekanizma efektivë përmes protokolleve transparente të pjesëmarrjes, dhe njohjes së kontributit të OJF-ve si partnerë legjitim në këtë proces.</p>

		Masa 4.3 Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit	100%	
		Masa 4.4 Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile	100%	
		Masa 4.5 Mundësimi i përfshirjes efikase të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian	100%	<p>Në lidhje me këtë masë është e paqartë se si është matur përfshirja efikase e OSHC-ve në punën e KKIE dhe arritja në 100 % e rezultatit. Gjatë vitit 2021, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE), një strukturë e rëndësishme në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, ka organizuar 4 takime dhe 3 aktivitete ndërgjegjëse. Gjithashtu, KKIE ka zgjedhur 14 anëtarë, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, të gjithë me seli në Tiranë.</p> <p>Një takim i posaçëm i KKIE-së u organizua në lidhje me kontributin dhe rolin e shoqërisë civile gjatë procesit të negociatave për integrimin evropian. Në këtë takim, përfaqësues të OJF-ve në Këshill, si dhe OJF të tjera të ftuara, shprehën shqetësimet e tyre ndaj institucioneve të cilat neglizhojnë kontributin e shoqërisë civile, mungesën e ndjekjes së çështjeve të ngritura në mbledhjet e këshillit, vonesat në krijimin e tryezave të diskutimit dhe këshillimit për kapitujt e negociatave. Ata theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në tryezat e diskutimit dhe këshillimit.</p>

	Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive duke u fokusuar veçanërisht në nivelin lokal	Masa 5.1 Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmin	0%	
		Masa 5.2 Përmirësimi i ligjit dhe akteve nënligjore të nevojshme për vullnetarizmin dhe zgjidhja e çështjes së sigurimeve bazuar në konceptin kombëtar	67%	Prej dy vitesh, Qendra Kombëtare Burimore në bashkëpunim me Përtej Barrierave dhe një grup organizatash që punojnë në fushën e vullnetarizmit, janë angazhuar në ndërgjegjësimin e institucioneve dhe organizatave mbi problematikën e kuadrit ligjor për vullnetarizmin në vend dhe nevojën për rishikimin tërësor të tij. Prej vitit 2021 ka nisur një dialog me institucionet përgjegjëse dhe në vitin 2022 është krijuar një grup pune me përfaqësues të qeverisë dhe OSHC-ve për rishikimin e ligjit. Qendra Kombëtare Burimore dhe Përtej Barrierave kanë paraqitur edhe një opinion ligjor dhe disa studime lidhur me problematikat e shumta të kuadrit ligjor në Shqipëri dhe praktika edhe të vendeve të tjera në rajon, BE dhe më gjerë. Në vijim, është kryer vetëm një takim prezantues i grupit të punës dhe nuk është kryer rishikimi i ligjit apo akteve nënligjore.
		Masa 5.3 Skema të financimit nga shteti për promovimin e punës vullnetare	100%	Nuk ka informacion publik mbi skema të financimit të shtetit për promovimin e punës vullnetare.
		Masa 5.4 Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare	63%	Nuk ka informacion publik lidhur me këtë.
		Masa 5.5 Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare	20%	Nuk ka informacion publik se si është nxitur vullnetarizmi, cilat kanë qenë masat që e kanë nxitur dhe kanë

				mbështetur përfshirjen e grupeve të përmendura.
Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave	Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OShC-ve	Masa 6.1 Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OShC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në eficientë për OShC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OShC-ve	100%	
		Masa 6.2 Ndryshimi i Ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OShC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OShC-ve	80%	Me ligjin e ri "Për regjistrimin e OJF-ve" procesi nuk ndodh në QKB, kështu që nuk ka se si të jetë arritur realizimi 80% i kësaj mase. Kjo masë duhet të hiqet nga plani i veprimit të Udhërrëfyesit.
		Masa 6.3 Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OShC-të	50%	Nuk ka informacion publik mbi këto akte.
	Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile	Masa 7.1 Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OShC-të me të gjitha funksionet	75%	
		Masa 7.2 Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OShC-ve	50%	
		Masa 7.3 Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AMSHC-së	27%	
Drejtimi strategjik 3: Kuatër fiskal dhe financues i favorshëm	Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OShC-ve në përputhje me praktikat e mira të BE-së	Masa 8.1 Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OShC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime	100%	Nuk ka asnjë informacion publik se cilat janë ligjet ekzistuese që janë ndryshuar. Si pjesë e kësaj mase ishte parashikuar dhe: parashikimi në PBA i fondeve të mbështetjes financiare të ndërmarrjeve sociale 2020-2022, ndërkohë që nuk është realizuar. Për më tej, lidhur me mbledhjet e Komisionit të Vlerësimit që duhet të mbledhet periodikisht, nuk ka informacion publik dhe as procesverbale.

		Masa 8.2 Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare	83%	Lidhur me këtë masë, janë realizuar procedurat e marrjes së statusit të NS por ende nuk është realizuar mbështetja financiare.
		Masa 8.3 Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social	100%	Nuk ka informacion publik. Sipas kësaj mase, parashikohet mbështetje e Qeverisë Vendore për hartimin e Planeve Sociale dhe parashikimin e ngritjes së shërbimeve sociale me bazë komunitare. Ndërkohë, nuk ka informacion mbi këtë. Tek porta vendore është publikuar informacion për 5 bashki, pa plane të përgjithshme vendore.
	Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve	Masa 9.1 Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar.	0%	
		Masa 9.2 Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve në aspektin e TVSh-së	100%	Sipas kësaj mase, parashikohet ngritja e një grupi pune për përgatitjen e projektndryshimeve në legjislacion. Nuk ka informacion publik dhe as vendim lidhur me këtë.
		Masa 9.3 Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OSHC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve	20%	Nuk ka informacion publik mbi hartimin e manualit.
		Masa 9.4 Ndryshimi i Ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OSHC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale	0%	